



Planuar / Propozuar / Proposed / Предложено	12-04-2021	1	116
Emri i Autorit / Name of Authority / Имя Авторитета	SPM SHCK	1725/2021	116



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.195/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Arben Mehmeti dhe Jeton Koca-Bajraktari-anëtarë dhe Avdyl Bektashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, bazuar në Aktgjykimin A.nr.2879/19 të datës 24.03.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, të pranuar me date 26.03.2021 kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.586/2019 të datës 25.09.2019 të parashtruar nga ankuesja kundër Vendimit me Nr.44/2019 të datës 30.08.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Ministrisë së Punëve të Brendshme, në çështjen juridike “kontestim konkursi”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosies së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 12.04.2021, mori këtë:

V E N D I M

I. REFUZOHET si e pabazuar ankesa me numër A.nr.586/2019, e datës 26.09.2019 e parashtruar nga ankuesja

II.MBETET në fuqi Vendimi me Nr.44/2019 i datës 30.08.2019, i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

A r s y e t i m

Ministria e Punëve të Brendshme ka shpallur konkursin e brendshëm me datë 21.06.2019 për pozitën “Udhëheqës i Divizionit për Menaxhimin e Kontratave” pas marrjes së autorizimit nga Departamenti i Administrimit të Shërimit Civil/Ministria e Administratës Publike të datës 20.06.2019

Në këtë konkurs ka aplikuar edhe ankuesja e cila është ftuar të marrë pjesë në fazat e procedurës së rekrutimit, por që nuk është përzgjedhur si kandidat i suksesshëm në këtë pozitë.

Me njoftimin e datës 09.07.2019 Ministria e Punëve të Brendshme ka shpallur kandidatin e suksesshëm për pozitën “Udhëheqës i Divizionit për Menaxhimin e Kontratave”.

Ankuesja e pakënaqur me mos përzgjedhjen e saj për vendin e punës “Udhëheqës i Divizionit për Menaxhimin e Kontratave” më datë 07.08.2019 ka parashtruar ankesë me numër protokoll Nr. 623/19 në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Ministrisë së Punëve të Brendshme, më datë 30.08.2019 ka nxjerr Vendim me numër Nr.44/2019 me të cilin ka refuzuar si të pabazuar ankesën e ankueses.

Ankuesja kundër Vendimit me numër Nr.44/2019 të datës 30.08.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Ministrisë së Punëve të Brendshme, bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 26.09.2019 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 4550/2019 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 03.10.2019, ankesën e ankueses e ka proceduar për përgjigje në ankesë tek Ministria e Punëve të Brendshme. Ministria e Punëve të Brendshme më datë 09.10.2019 ka përcjell dokumentacionin e kërkuar.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nga muaji janar i vitit 2019 deri më datë 08.10.2020 ka qenë jo funksional dhe nuk ka vendosur për ankesën e ankuesit, ndërsa më datë 04.11.2019, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka njoftuar ankuesen për arsytet e mos shqyrtimit të ankesës duke udhëzuar që mund të ndiqni procedurat e mëtejme dhe se në pajtim me Ligjin për Konfliktin Administrativ mund të filloni procedurën gjyqësore pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative.

Ankuesja ka ndjekur procedurat e tjera duke iniciuar konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative. Gjykata Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative më datë 24.03.2021 ka nxjerr Aktgjykim A.nr.2879/19 me të cilin ka aprovuar kërkesëpadinë e paditëses duke anuluar njoftimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të datës 04.11.2019 dhe duke e detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës që brenda 30 ditësh të vendos për ankesën e datës 26.09.2019.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave për marrjen e vendimit meritore ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokollit 4550/2019 të datës 26.09.2019 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; E-mailin nga Personeli MPB për ankuesin i datës 02.09.2019; Vendimin me Nr.44/2019 të datës 30.08.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Ministrisë së Punëve të Brendshme; Njoftimin me Nr.539/19 të datës 09.07.2019 për kandidatin e suksesshëm; Ankesën me Nr. 623/19 të datës 07.08.2019 të parashtruar nga ankuesja në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Ministrisë së Punëve të Brendshme; Autorizimin e datës 02.07.2019 nga Sekretari i Përgjithshëm i MPB-së; Deklaratën e datës 02.07.2019; Konkursin e shpallur nga Ministria e Punëve të Brendshme për pozitën “Udhëheqës i Divizionit për Menaxhimin e Kontratave”; Autorizimin e Departamentit të Administrimit të Shërbimit Civil/Ministrisë së Administratës Publike të datës 20.06.2019; Vendimin me Nr. 471/19 i datës 01.07.2019 për themelimin e Komisionit Përzgjedhës të Shërbimit Civil; Vendimin me Nr. 482/19 i datës 02.07.2019 për plotësim/ndryshimin e Komisionit Përzgjedhës të Shërbimit Civil; Akt Emërimit e datës 16.10.2013, 03.10.2013, 31.01.2013; Ndryshim i aktit të emërimit i datës 13.07.2015, 02.12.2013; Formularin Form. MAP-SHCK-04 për Regjistrin e Aplikacioneve të pranuar; Regjistri i aplikacioneve të listës së ngushtë i datës 02.07.2019; Lista e ngushtë e aplikantëve që kanë hyrë në testin me shkrim e datës 04.07.2019; Lista e aplikantëve sipas pikëve të fituara në testin me shkrim datë 04.07.2019; Lista e aplikantëve për interviste me gojë e datës 05.07.2019; Pyetjet e intervistës me gojë; Formularin Form. MAP-SHCK-05 për përcaktimin e kriterëve për përfshirjen në listën e ngushtë i datës 02.07.2019; Formularin Form. MAP-SHCK-07a për përcaktimin e kriterëve për testimin me shkrim dhe me gojë për vendin e punës për të cilin nuk

kërkohej njohja e ndonjë gjuhe të huaj; Formularin për përmbledhjen e vlerësimeve individuale i datës 09.07.2019; Raporti Përmbledhës i datës 09.07.2019; Testin me shkrim i ankueses dhe kandidatës i datës 04.07.2019; Kërkesën për punësim të kandidatës

Diplomën e datës 14.06.2000, 19.11.2004, 24.07.2013 dhe 19.01.2017 të kandidatës
Formulari për vlerësimin e rezultateve në punës i datës 03.01.2019 dhe 18.01.2018 për kandidaten Kimete Shqairi; Vendimin me Nr. 53/2016 i datës 26.01.2016 për kandidaten

Certifikatën 15-18.05.2015; Certifikatën 24-25.11.2016, Certifikatën 2-17.03.2010; Certifikatën e datës 10.12.2012; Diplomën shtator 2003; Mirënjohje e datës 17.05.2012; Vendimin me Nr. 771 të datës 26.11.2015, Vendimin me Nr. 751 të datës 20.10.2017 për kandidaten

Akt Emërimit të datës 31.01.2013 për kandidaten Kontratën e marrëdhënies së punës për kandidaten Kimete Shaqiri; Kërkesën për punësim të ankueses; Vendimin me Nr. 767 të datës 17.10.2018 për ankuesen; Akt Emërimit të datës 14.09.2016 dhe 14.09.2015 të ankuesen; Kontratë pune për ankuesen; Diplomën e datës 13.06.2011 për ankuesen; Certifikatën për ankuesen; Certifikatën e datës 07.01.2011 për ankuesen; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë datë 15.12.2017 për ankuesen; Formularin për vlerësimin e punës provuese i datës 14.09.2015 për ankuesen; Marrëveshjen për shërbime të veçanta e datës 24.07.2015, 15.04.2015 për ankuesen; Vendimin me Nr.404 të datës 31.05.2019 dhe Përgjigjen në ankesë e datës 09.10.2019; Njoftimin e datës 04.11.2019 për ankuesen; Aktgjykimin A.nr.2879/19 të datës 24.03.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar që ankesa e ankueses

është e pa bazuar, sepse:

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankueses e cila pretendon që Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave nuk ka vendosur në pajtim Ligjin për Procedurën e Përgjithshme Administrative pasi që nuk ka shqyrtuar në tersi pretendimet ankimore në ankesë; Kandidatja e përzgjedhur nuk plotëson kushtet e konkursit pasi nuk ka shkollim adekuat dhe nuk ka përvojë punë relevante në menaxhim; Komisioni Përzgjedhës ka qenë i themeluar në kundërshtim me Rregulloren Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil sepse dy pozita janë të nivelit të divizionit e njëjtë me procedurën që rekrutohet, po ashtu komisioni nuk është i përbërë në aspektin etnik.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, lidhur me pretendimin ankimor të ankueses e cila pretendon që Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave nuk ka vendosur në pajtim me Ligjin për Procedurën e Përgjithshme Administrative pasi që nuk ka shqyrtuar në tersi pretendimet ankimore në ankesë, ka konstatuar që Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Ministrisë së Punëve të Brendshme me rastin e nxjerrjes së Vendimit me Nr.44/2019 të datës 30.08.2019, ka shqyrtuar në tersi procedurën e rekrutimit dhe ka konstatuar që e njëjta është zhvilluar në pajtim me legjislacionin në fuqi për shërbimin civil, rrjedhimisht pretendimi i ankueses është i pabazuar

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se në konkursin e datës 21.06.2019 të shpallur nga Ministria e Punëve të Brendshme për pozitën "Udhëheqës i Divizionit për Menaxhimin e Kontratave" kriteret e konkursit kanë qenë:

- *Diplomë universiteti: Fakulteti Ekonomik, Fakulteti Juridik dhe Shkenca tjera Shoqërore.*
- *Të ketë së paku 5 vjet përvojë pune relevante, në menaxhim të detyrave të caktuara*

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, në bazë të shkresave të lëndës të dorëzuara nga ankuesja, si dhe organi i punësimit ka konstatuar që procedura e rekrutimit për pozitën e punës "Udhëheqës i Divizionit për Menaxhimin e Kontratave", e shpallur me datë 21.06.2019 nga Ministria e Punëve të

të Kosovës, ku është përcaktuar se: **“Pranimi në Shërbimin Civil mbështetet në parimet e meritës, me shpallje publike të pozitive të lira, me transparencë të procesit, me objektivitet dhe paanësinë e komisionit testues, mosdiskriminimin e kandidatëve dhe të drejtën për t’u ankuar në fund të procedurës”**, pasi ka marrë autorizimin nga Ministria e Administratës Publike DASHC/MAP me datën 20.06.2019 dhe se pretendimet ankimore të ankueses nuk janë të qëndrueshme lidhur me zhvillimin e procedurës së rekrutimit.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, lidhur me pretendimin ankimor të ankueses e cila pretendon që kandidatja e përzgjedhur nuk plotëson kushtet e konkursit pasi nuk ka shkollim adekuat dhe nuk ka përvojë punë relevante në menaxhim, konstaton që Departamenti për Administrimin e Shërbimit Civil i Ministrisë së Administratës Publike më datë 20.06.2019 ka miratuar kërkesën e Ministrisë së Punëve të Brendshme ku ka përcaktuar kriteret që duhet përcaktuar në konkurs, kështu që Ministria e Punëve të Brendshme në konkursin e datës 21.06.2019 për pozitën **“Udhëheqës i Divizionit për Menaxhimin e Kontratave”**, ka përcaktuar kriteret sipas autorizimit të DASHC te datës 20.06.2019, rrjedhimisht në bazë të këtyre kriterëve Komisioni Përzgjedhës i Shërbimit Civil ka përgatitur listën e shkurtër ku në të janë përfshirë ankuesja dhe kandidatja Kimete Shaqiri-Rexhepi si kandidat e suksesshme, dhe se Komisioni Përzgjedhës e ka vlerësuar drejtë dhe në pajtim me nenin 28 paragrafin 1 nënparagrafin 1.2 dhe nenin 2, 3, 4 të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil ku thuhet: **“Anëtarët e KPSHC-së vlerësojnë aplikacionet në bazë të kriterëve në vijim:...,1.2. përvojën e punës”, secili anëtar vlerëson kandidatin në secilin kriter. Numri maksimal i secilit kriter është 20 pikë. Numri maksimal është 80, ndërsa minimumi për vazhdimin e kandidatit në procedura të tjera është 40 pikë. Kandidatet, të cilët nuk arrijnë numrin minimal të pikëve përjashtohet nga fazat e tjera të përzgjedhjes”**.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar pretendimin e ankueses se komisioni përzgjedhës nuk i ka bërë vlerësimin real të përvojës së punës dhe kualifikimit në krahasim me kandidaten e përzgjedhur, ka konstatuar se ky pretendim është i paqëndrueshëm sepse nga dëshmitë e ofruara nga organi i punësimit për përgatitjen profesionale dhe përvojën e punës kandidatja e përzgjedhur ka përvojë të punës në pajtim me kriteret e e kërkuara në konkursin e datës 21.06.2019 ashtu siç është kërkuar për vendin e punës **“Udhëheqës i Divizionit për Menaxhimin e Kontratave”** „Diplomë universiteti: Fakulteti Ekonomik, Fakulteti Juridik dhe Shkenca tjera Shoqërore.” si dhe **„Të ketë së paku 5 vjet përvojë pune relevante, në menaxhim të detyrave të caktuara”** sepse në bazë të dëshmive kandidatja e përzgjedhur, posedon Diplomë Universitare me Nr. 693 të datës 19.11.2004 të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës me të cilën dëshmohet se më datë 19.11.2004 ka përfunduar Shkollën e Lartë Pedagogjike, posedon Diplomën me Nr. 1249 të datës 24.07.2013 të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës me të cilën dëshmohet se më datë 09.07.2013 ka mbaruar studimet në Fakultetin e Edukimit duke marr titullin **“Bachelor i Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe”**, si dhe me përvojë të punës si në vijim; posedon Kontratën e Punës ku nga data 01.06.2004 deri më datë 31.01.2013 ka punuar në pozitën **“Zyrtar i Regjistrimit Civil”** në QKRC në Prishtinë-MPB, posedon Akt Emërimin e datës 31.01.2013, ku dëshmon se ka punuar nga data 31.01.2013 deri më datë 26.11.2015 në Ministrinë e Punëve të Brendshme në pozitën **“Zyrtare e Regjistrimit Civil”** QKRC në Prishtinë, posedon Vendimin me Nr. 771 të datës 26.11.2015 , ku dëshmohet se nga data 26.11.2015 deri më datë 20.10.2017 ka ushtruar detyrën e „Udhëheqëses së Sektorit të Verifikimit” në Ministrinë e Punëve të Brendshme ndërsa nga data 20.10.2017 deri më 20.11.2017 ka ushtruar detyrën e „Udhëheqëses së Sektorit për Dokumente të Udhëtimit” në Ministrinë e Punëve të Brendshme, dhe nga data 20.11.2017 - vazhdon në Ministrinë e Punëve të Brendshme në pozitën **“Zyrtare e Regjistrimit Civil”**, andaj si rrjedhojë e kësaj dhe në bazë të provave të lëndës, kolegji ka konstatuar se kandidatja e përzgjedhur i ka plotësuar kushtet e përcaktuara të konkursit, dhe me rastin e përfshirjes së saj në listë të shkurtër Komisioni Përzgjedhës i Shërbimit Civil ka vepruar në pajtim me dispozitat e nenit 28 paragrafit 1 nën paragrafit 1.1 dhe 1.2 të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, i cili përcakton se:

punës, shkathësia dhe aftësitë dhe elementet e tjera të meritë”, kështu që ky pretendim i ankueses është i pabazuar.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, lidhur me pretendimin ankimor të ankueses e cila pretendon që Komisioni Përzgjedhës ka qenë i themeluar në kundërshtim me Rregulloren Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil sepse dy pozita janë të nivelit të divizionit e njëjtë me procedurën që rekrutohet, po ashtu komisioni nuk është i përbërë në aspektin etnik, ka konstatuar që Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Brendshme me datë 01.07.2019 ka nxjerr Vendim me Nr. 471/19 për themelimin e Komisionit Përzgjedhës të Shërbimit Civil ndërsa më datë 02.07.2019 ka nxjerr Vendim me Nr. 482/19 për plotësim/ndryshimin e Komisionit Përzgjedhës të Shërbimit Civil me këtë përbërje:

1. *Drejtor i Departamentit për Siguri Publike/MPB-kryesues,*
2. *rektor i Departamentit për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme/MPB-anëtare,*
3. *Drejtor i Departamentit të Prokurimit-anëtar,*
4. *Udhëheqëse e Divizionit për Financa-anëtare dhe*
5. *Drejtor i Departamentit për Shtetësi, Azil dhe Migracion-anëtar.*

Në këtë kuptim Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, duke shqyrtuar këtë përbërje të Komisionit Përzgjedhës të Shërbimit Civil, dhe duke u bazuar edhe në Katalogun e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil dhe në Akt Emërimet e të gjithë anëtarëve të komisionit, ka konstatuar se katër (4) anëtarë të Komisionit Përzgjedhës të Shërbimit Civil (*Drejtor i Departamentit për Siguri Publike, Drejtor i Departamentit për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme, Drejtor i Departamentit të Prokurimit dhe Drejtor i Departamentit për Shtetësi, Azil dhe Migracion*) mbajnë pozita më të larta se pozita që rekrutohet, ndërsa një (1) anëtar i Komisionit Përzgjedhës të Shërbimit Civil (*Udhëheqëse e Divizionit për Financa*) mbanë pozitë të njëjtë me pozitën që rekrutohet, në këtë rast ky komision është themeluar në pajtim me nenin 7 paragrafin 1 të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, i cili përcakton se: **“Institucionet themelojnë një Komision përzgjedhës ad hoc të Shërbimit Civil (në tekstin në vijim: KPSHC), i cili zhvillon procedurat e rekrutimit. KPSHC përbëhet nga anëtarë të cilët kanë pozita më të lartë se pozita që duhet të rekrutohet, po një anëtar mund të ketë pozitën e njëjtë, të jetë shumetnik dhe me përfaqësim gjinor”,** po ashtu Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se Ministria e Punëve të Brendshme më datë 02.07.2019 ka nxjerr deklaratën për mos përmbushje të kriterit në aspektin etnik të Komisionit Përzgjedhës të Shërbimit Civil, duke vepruar në pajtim me nenin 7 paragrafin 2 të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, i cili përcakton se: **“Nëse KPSHC nuk mund të themelohet në bazë të paragrafit 1 të këtij neni, Menaxheri i Njësisë së Personelit të Institucionit përkatës përgatit një deklaratë me shkrim ku përshkruan arsyet e mos përmbushjes së kërkesave”,** rrjedhimisht ky pretendim i ankueses është i pabazuar.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka konstatuar se ankuesja i është nënshtruar procedurës së rekrutimit në të gjitha fazat e rekrutimit e cila pas testit me shkrim dhe intervistës me gojë është renditur e dyta (2), duke u bazuar në Raportin përmbledhës të datës 09.07.2019 të Komisionit Përzgjedhës të Shërbimit Civil, dhe ka arritur gjithsejtë 69.75% të pikëve të përgjithshme nga testi me shkrim dhe intervista me gojë, kurse kandidatja e përzgjedhur është renditur e para pas vlerësimit të testit me shkrim dhe me gojë dhe ka arritë gjithsejtë 82.8% të pikëve të përgjithshme, dhe mbi këtë bazë është konstatuar se Komisioni Përzgjedhës i Shërbimit Civil, gjatë vlerësimit të testit me shkrim dhe me gojë ka vepruar në pajtim me dispozitat e nenit 37 dhe 39 të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, po ashtu konstaton se përzgjedhja e kandidatës është bërë në pajtim edhe me dispozitat e nenit 40 paragrafi 1 dhe paragrafi 3 të Rregullores Nr. 02/2010 për

Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, i cili përcakton se: *“Në shërbimin civil emërohen kandidatët të cilët kanë arritur numrin më të madh total të pikëve në testimin me shkrim dhe me gojë”, “Kandidat i suksesshëm konsiderohet ai, i cili në testin e përgjithshëm (testin me shkrim dhe me gojë) ka jo më pak se 60% të maksimumit të pikëve të caktuara”,* mbi bazë të kësaj në shërbimin civil emërohen kandidatët që kanë arritur numrin më të madh të pikëve në rastin konkret konkursi është shpallur për një (1) pozitë dhe në bazë të Raportit përmbledhës të datës 09.07.2019 ankuesja pas vlerësimit të testit me shkrim dhe me gojë ka arritur gjithsejtë 69.75% pikët e përgjithshme, dhe është renditur e dyta (2) në liste.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka konstatuar se Ministria e Punëve të Brendshme lidhur me zhvillimin e procedurës së rekrutimit dhe përzgjedhjes së kandidatit, për pozitën *“Udhëheqës i Divizionit për Menaxhimin e Kontratave”*, ka vepruar në pajtim me nenin 11 paragrafin 1 të Ligjit nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës, ku përcaktohet se: *„Pranimi në Shërbimin Civil të Kosovës bëhet në pajtim me parimet e meritës, aftësisë profesionale, paanshmërisë, mundësive të barabarta, mos diskriminimit dhe përfaqësimit të barabartë, në bazë të konkursit publik dhe pas verifikimit të zotësisë së veprimit të kandidatëve”.*

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar që Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik me rastin e nxjerrjes së Vendimit me numër Nr.44/2019 të datës 30.08.2019, ka vepruar në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligjit Nr. 05/L-31 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe Rregulloren Nr. 05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe Ankesave, duke arritur të konstatojë drejtë gjendjen faktike dhe bazën juridike.

Duke marr parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe provat e bashkëngjitura në lëndë, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave duke u bazuar në kompetencën e Këshillit si dhe bazuar në Aktgjykimin me numër A.nr.2879/19 të datës 24.03.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi..

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.195/2021

Avdyt BEKTESHI,

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Malsore GASHI-BAJRAKTARI,

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet

- Ankueses
- Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së